

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**, departamenti i pergjithshem-divizioni civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe procesmbajtësen Minire Krasniqi, ne ceshtejn kontestimore te inicuar me padine e paditeses R [REDACTED] L [REDACTED] nga Ferizaj kunder te paditurit T [REDACTED] N [REDACTED] ish nga Ferizaj tani me adrese te panjohur te cilin e perfaqeson perfaqesuesi i perkohshem av. [REDACTED] nga Ferizaj, ne shqyrtimin kryesor mbajtur me date 14.10.2015, ne pranine e paleve ndergjygjese me date 16.10.2015, merr dhe publikon kete:

**A K T G J Y K I M**  
- në bazë të pohimit -

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit R [REDACTED] L [REDACTED] nga Ferizaj, në tërësi si e bazuar.

**OBLIGOHET** i padituri T [REDACTED] me adrese te panjohur, qe paditesit t'ia njoh te drejten e pronesisë ne parcelen kadastrale numer 1096-2 me sipërfaqe prej 743 m<sup>2</sup>, are e klases 3 ZK Ferizaj, dhe te lejon regjistrimin e saj, ne emer te paditesit, ne regjistrat kadastral , kete ne afat prej 15 ditesh, pas plotefuqishmerise se ketij aktgjykimi, nen kerçenimin e permbarimit me dhune.

Obligohet paditesi qe te paguan taksen gjyqesore per Aktgjykim ne shume prej 230.00€, si dhe shpenzimet e perfaqesuesit te perkohshem ne shume prej 780.30€, pas pranimit te ketij aktgjykimi nen kerçenimin e pasojave juridike.

**A r s y e t i m i**

Paditësi ka ushtruar padi kundër të paditurit, për vertetim pronesisë.

Perfaqesuesi i perkohshem i te paditurit në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar shprehimisht se nuk e konteston kërkesepadine e paditesit, duke qene se kërkesepadia e paditesit eshte provuar si e bazuar ne prova.

Meqenese se i padituri nuk ka kontestuar kërkesepadine e paditesit dhe ka pohuar ekzistimin e fakteve vendimtare te cilat e bejne te bazuar kërkesepadine e tij, ndersa ne anen tjetër gjykata ka vlerësuar se nuk ekzistojne pengesa ligjore nga neni 148.2 te LPK-se, per marrjen e aktgjykimit ne baze te pranimit ne kuptim te nenit 148 te LPK-se.

Gjykata ka obliguar paditesin te paguan taksen gjyqesore per aktgjykim ne baze te UA nr.2008-2 te KGJK-se, per unifikimin e taksave gjyqesore, ndersa per shpenzimet e perfaqesuesit te perkohshem ne baze te nenit 81.2 lidhur me nenin 453.2 te LPK-se e mbeshetur ne tarifat e OAK-se.

Mbi bazen e parashtrimeve te mesiperme ehste vendsour si ne dispozitiv te ketij Aktgjykimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

nr.284/14 date 16.10.2015

OSNOVNA JE PRAVOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC

Gjyqtari,  
Enes Mehmeti



**KESHILLA JURIDIKE:** Kunder aktgjykimi eshte e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditesh, pas pranimit te kopjes se tij , ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, permes kesaj gjykate.